

KRYEARTIKULL

LISTËS SË ANËTARËSISË PREJ 46 ANËTARËSH TË SHOQATËS PËR AUTONOMI VENDORE I BASHKOHEN EDHE 14 BASHKI TË REJA.

Mblidhet Asambleja e Shoqatës për Autonomi Vendore: Merren vendime të rëndësishme.

VIJON NE FAGEN 2



EDITORIAL

SHAV MBËSHTET PUSHTETIN VENDOR NË TEJKALIMIN E SITUATËS SË EMERGJENCEVE POST-TËRMETIT

Tërmeti i datës 26 nëntor shkaktoi 51 viktima dhe mbi 900 të plagosur, duke lënë pas qytete dhe fshatra të dëmtuar rëndë, përfshi edhe dy qytetet më të mëdha të vendit, kryeqytetin Tiranë dhe Durrësin. Nisur nga kjo situatë, që në momentet e para SHAV u angazhua për përcjelljen dhe koordinimin e informacionit mes strukturave të pushtetit qendror dhe atij vendor në kuadër të menaxhimit të krizës së emergjencës.



Nga ana tjetër, kjo situatë evidentoi mungesën e planeve strategjike dhe financiare, mungesën e strukturave përkatëse, si dhe mos zbatueshmëria ligjore për këto situata, kryesisht në nivelin vendor. Për këtë arsye, SHAV ka kërkuar ekspertizë ndërkombëtare dhe lokale nga organizatat si motra si

VIJON NE FAGEN 3

FORUMI LOKAL

INTERVISTË Adelina Farrici

Çfarë po kërkojnë bashkitë? Buxheti 2020, borxhet e akumuluar, korrigjimi i hartës territoriale, politikat fiskale, etj.

6



AKTIVITETE

SHAV merr pjesë në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Këshillin e Europës

Zhvillohen takime të nivelit të lartë me në fokus të drejtat dhe ligjin për pushtetin vendor në Shqipëri.

4



SHTYLLAT KRYESORE



AUTONOMIA VENDORE



DECENTRALIZIMI



DEMOKRACIA LOKALE



RRITJA E KAPACITETEVE



EDUKIMI DHE SPORTI



MJEDISI

Përmbajtja

JANAR 2020 NUMRI 4



03 EDITORIAL

- SHAV mbështet pushtetin vendor në tejkalimin e situatës së emergjencave post-tërmetit

04. AKTIVITETE

- Kongresi i Këshillit të Evropës
- Këshilli Konsultativ
- Komisioni i Ligjeve
- Renta e Industrisë së rënd
- Vjetari Statistikor Rajonal
- Marmara Urban Forum 2019

06. FORUMI LOKAL

- Intervistë me Drejtoreshën Ekzekutive të Shoqatës për Autonomi Vendore, Adelina Farrici mbi Buxhetin 2020

10. HISTORI SUKSESI, PROJEKTI SUMP

- Shqipëria bëhet pjesë e 3136 qëndrave administrative evropiane që synojnë ndërgjegjësimin e qytetarëve për përdorimin e transportit ekologjik
- Trajnimi për Menxhimin e Ciklit të Projektit nga bashkitë e vendit siguron më tepër projekte zhvillimi për komunitetet lokale



**SHOQATA
PËR AUTONOMIË
VENDORE**

Adresa

Rruga Reshit Çollaku,
Pallati 38 shkalla 2 ap. 13/1,
Tiranë, Shqipëri

Email: info@shav.al

LISTËS SË ANËTARËSISË PREJ 46 ANËTARËSH TË SHOQATËS PËR AUTONOMI VENDORE I BASHKOHEN EDHE 14 BASHKI TË REJA



Në mbledhjen e parë të Shoqatës për Autonominë Vendore, u diskutua situata e krijuar nga tërmeti në 11 bashki të vendit, integrimi i vendit dhe roli që bashkitë duhet të kenë në këtë proces si dhe u morën disa vendime të rëndësishme siç ishte ai i pranimit të 14 bashkive të tjera si anëtare të reja të SHAV.

Në fjalën e tij hapëse, Presidenti i Shoqatës për Autonomi Vendore Erion Veliaj tha se, përmes një telefonate nga homologu i tij në Londër, Sadiq Kahn, ai ka marr mbështetje maksimale nga kjo bashki për kapërcimin e situatës së krijuar nga tërmeti.

Kryetari Veliaj, theksoi se në këto momente, krahas bizneseve dhe ambasadave, edhe një numër i konsiderueshëm bashkish nga vende të ndryshme kanë shprehur

gatishmërinë për të kontribuar për përballimin e situatës që u krijua si pasojë e tërmetit të para disa muajve.

Gjatë kësaj mbledhje u bë pranimi i 14 bashkive të reja të cilat nga ky moment janë anëtare të Shoqatës së Autonomisë Vendore. Gjithashtu krerët e bashkive ranë dakord që të rakordojnë propozimet që do bëjnë sa i përket përgatitjes së projektbuxhetit të ri. Veliaj ka përshëndetur vendet që janë "Pro" çeljes së negociatave të Bashkimit European me Shqipërinë dhe kërkoi prej bashkive që të rrisin kapacitetet për të përfituar përmes projekteve të ndryshme me BE-në.

Lidhur me strehimin, Veliaj theksoi e ka ardhur koha për decentralizimin dhe këtë kompetencë do e kenë bashkitë.

SHAV MBËSHTET PUSHTETIN VENDOR NË TEJKALIMIN E SITUATËS SË EMERGJENCAVE POST-TËRMETIT

VIJON NGA FAGE 1

dhe ka bashkëpunuar për hulumtin dhe vlerësimin e situatës në terren si dhe publikimin e studimeve me rekomandime për tejkalimin e situatës së emergjencës post-tërmet. Së pari, Shoqata për Autonomi Vendore menjëherë pas një vlerësimi paraprak të situatës në fazën e saj fillestare, iu drejtua Rrjetit të Shoqatave të Autoriteteve Lokale në Evropën Jug-Lindore (NALAS), për të asistuar me ekspertizë në procesin e menaxhimit të krizës të post-tërmetit. NALAS iu pergjigj menjëherë thirrjes për ndihmë nga SHAV duke sjellë ekspertë me përvojë, nga Turqia, Maqedonia dhe Sllovenia, në menaxhimin e krizave me qëllimin e bashkëpunimit me ekspertët në vend për të siguruar mbështetje për të 3 bashkitë e qarqeve Tiranë, Durrës dhe Lezhë të prekur nga tërmeti. Për disa ditë me radhë, drejtoresha Zj. Adelina Farrici dhe ekipi i SHAV, shoqëruan ekspertët në terren së bashku me përfaqësues të bashkive të prekur nga tërmeti. Procedura e ekzaminimit të situatës së emergjencës në fazën fillestare në bashkitë e prekur dhe rekomandimet e ofruara nga ekipi ekspertëve ishin të vlefshme për autoritetet lokale në kuadër të ndjekjes së hapave të metejshme në fazën e parë post-emergjente. Në të njëjtën kohë, së bashku edhe me projektin “Bashki të Forta”, Shoqata për Autonomi Vendore ka bashkëpunuar në hartimin e një studimi serioz në favor të vlerësimit të situatës. Evidentimi i nevojave dhe rekomandimeve në pushtetin vendor në fushën e mbrojtjes civile për zbatimin efektiv të ligjit 45/2019 “Per mbrojtjen civile” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij nga bashkitë, strukturat e tyre, koordinimi dhe mbështetja e strukturave qendrore për parandalimin, zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe forcimin e



sistemit të mbrojtjes civile ishin thelbi i këtij studimi. Krahas informacioneve të gjetura mbi mbledhjen e të dhënave për emergjencat civile, të bazuara në kuadrin ligjor, studime, raporte e analiza statistikore, pjesë e rëndësishme e analizës ishte dhe intervistimi i aktoreve kyç në pushtetin qendror dhe lokal, veçanërisht në qarqet më të prekura nga tërmeti. Disa prej evidentimeve dhe gjetjeve kryesore të këtij studimi flasin për mos miratim apo përditësim të Planeve Vendore për Emergjencat Civile, si dhe në disa raste mungesë koordinimi mes strukturave vendore të emergjencave civile dhe atyre qendrore, apo dhe aktorëve të tjerë jointitucional. Gjithashtu shihet nevoja për investime në burime njerëzore përmes trajnimit të strukturave të emergjencave civile dhe infrastrukturës logjistike me standardet më bashkëkohore. Por edhe mungesë të fondeve nga buxheti i shtetit dedikuar për emergjencat, apo mos respektimi i hartave sizmike në procesin e dhënies së lejeve të ndërtimit. Bashkia është aktori kryesor operacional që merret me zbatimin e planit të emergjencës, bazuar në parimin e autonomisë lokale, ndaj njësitë administrative duhet të kenë burime njerëzore të kualifikuara për menaxhimin e territorit në drejtim të raportimit dhe koordinimit në fushën humanitare. Rritja e kapaciteteve njerëzore në pushtetin vendor do të ndihmonte në hartimin dhe miratimin e Dokumentit të Vlerësimit dhe

zvogëlimin të rrezikut nga fatkeqësitë, të Planit Vendor për Emergjencat Civile dhe për krijimin e Bazës së të Dhënave për humbjet nga fatkeqësitë në territorin e bashkisë. Me rëndësi të veçantë u vlerësua edhe Organizimi i strukturave vendore të mbrojtjes civile, sipas kërkesave të ligjit 45/2019 dhe hartimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit me perparësi; pajisje me mjetet e domosdoshme që duhet të kenë strukturat e emergjencave për parandalimin, konstatimin dhe menaxhimin e një fatkeqësie natyrore. Fuqizimi i shërbimit zjarrfikës, shtimi i mjeteve dhe i buxhetit vendor duhet të jenë prioritetet e Bashkive dhe pushtetit qendror në rast emergjencash. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për menaxhimin e fatkeqësive natyrore apo të shkaktuara nga njeriu. Fuqizimi i strukturave të shërbimit social pranë bashkive për përballimin e situatave emergjente është gjithashtu një element i rëndësishëm për përballimin e situatave të katastrofave humanitare. Se fundmi, SHAV në bashkëpunim me Flag, mbështetur në projektin e sigurisë publike, financuar nga ambasada e Mbretërisë së Hollandës në Shqipëri, do të ngrejë komisionin e sigurisë publike me përfaqësues dhe specialistë nga bashkitë, të trajnuar nga ekspertë vendas dhe të huaj, i cili do të atashohet pranë strukturës së Shav dhe do të shërbejë për përpilimin e studimeve, udhëzimeve dhe raporteve mbi mbrojtjen civile.

Arritje

AKTIVITETE

Shoqata për Autonominë Vendore ka zhvilluar një numër aktivitete të rëndësishme gjatë tremujorit të vitit të kaluar

Shoqata për Autonomi Vendore mori pjesë në seksionin e 37 të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Këshillin e Evropës më 29 Tetor 2019 me një delegacion të përbërë nga Zj. Adelina Farrici, Sekretare e Delegacionit dhe Drejtoresha e SHAV, Z. Sotiraq Filo, Kryetar i Bashkisë Korçë, Zj. Majlinda Bufi, Kryetare e Bashkisë Roskovec, Zj. Juliana Memaj, Kryetare e Bashkisë Ura Vajguore dhe Zj. Valbona Sako, Bashkia Durrës, ku u diskutua mbi Rolin e Këshillit të Evropës në lidhje me garantimin e të drejtave të 47

shteteve anëtare të Kongresit dhe të drejtat njerëzore si standardet ligjore. Midis takimeve të shumta me sekretarë të delegacioneve homologe nga 47 shtete anëtare të Kongresit dhe grupe politike Evropiane ai më me rëndësi ishte takimi me Presidentin e Kongresit z. Anders Knape dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kongresit z. Andreas Kiefer. SHAV e njohu Presidentin me zhvillimet më të fundit në vend, situatën e Pushtetit Lokal si dhe diskutoi gjithashtu mbi nivelin e bashkëpunimit që vendi ynë ka me Kongresin.



KËSHILLI KONSULTATIV: DISKUTOHEN 11 PROJEKT-AKTE TË RËNDËSISHME PËR PUSHTETIN VENDOR

Një ndër aktivitetet ku SHAV mori pjesë në muajin Nëntor ishte gjithashtu edhe mbledhja e radhës e Këshillit Konsultativ ku u diskutuan 11 projekt-akte nga ministritë e linjës në procesin e decentralizimit të qeverisjes vendore çka kanë një impakt të konsiderueshëm në komunitetet lokale. Këto projektligje kanë për qëllim mbrojtjen e pyjeve dhe mjedisit në zonat rurale si dhe mirëmenaxhimin e integruar të mbetjeve. Gjithashtu një aspekt tjetër kishte të bënte me rregullat dhe procedurat e privatizimit, programet e strehimit, punësimit, arsimit, kujdesit shëndësor dhe politikave sociale për grupet e marginalizuara dhe moshën e tretë.

Sferat

AUTONOMIA VENDORE

Përmes forcimit të autonomisë vendore synohet më shumë të drejta dhe liri për qytetarët brenda një njësie të caktuar vendore. Në këtë aspekt, më shumë mundësi për vetëqeverisje përmes strukturave dhe mekanizmave demokratik të zgjedhur prej tyre, do të thotë më shumë mundësi për zhvillim të qëndrueshëm lokal.

DECENTRALIZIMI

Transferimi i më shumë pushteti nga qeverisja qendrore drejt bashkive të vendit sjell një zvogëlim domethënës në kohën e marrë për vendimmarrjen, reduktimin e kostove administrative dhe plotësimin e nevojave reale të komunitetit.

DEMOKRACIA LOKALE

Gjithëpërfshirja e qytetarëve, sektorit privat dhe organizatave jo qeveritare të komunitetit në proceset vendimmarrëse lokale dhe zotërimi në duart e tyre të mekanizmave të llogaridhënies është një parakusht për një demokraci lokale funksionale.

Kryesore

RRITJE E BUXHETIT PËR PUSHTETIN VENDOR DHE MË SHUMË FOKUS NË DREJTIM TË SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE PËR QYTETARËT

Në mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për Shqyrtimin e projektligjit për buxhetin 2020 mbajtur më 21 Nëntor 2019, Shoqata për Autonomi Vendore e përfaqësua në nga Kryetari i saj Kryetari i Bashkisë Tiranë, Z. Erion Veliq dhe Zj. Adelina Farrici, Drejtore Ekzekutive e SHAV, të cilët parashtruan rekomandimet dhe komentet e tyre në lidhje me buxhetin për pushtetin vendor dhe "Paketën Fiskale 2020" duke kërkuar:

- Zbatimi i ligjit për Transfertat e Pakushtëzuara jo më pak se 1% e PBB
- Ndarjen dhe transferimin në buxhetin e bashkive të vlerës prej 2% e Tatimit të të Ardhurave Personale
- Rritjen e Rentës Minerare
- Heqjen e borxheve të trashëguara nga investimet e FZHR

SHAV në propozimet e bëra u fokusua tek rritja e buxhetit për pushtetin vendor për më shumë shërbime



për qytetarët dhe investime për komunitetin e njësive vendore të vendit.

ZHVILLOHET TAKIMI I PARË TEKNIK MBI RENTËN NË INDUSTRIJË E RËNDË

Muaji Nëntor ishte dhe muaji i zhvillimit të takimit të parë teknik në Tiranë nga Shoqata për Autonomi Vendore mbi platformën për rentën në industrinë e rëndë, me pjesëmarrje të përfaqësues të sekretariatit të Albeit, përfaqësuesja e misionit të OSBE-së në vendin tonë, si dhe ekspertë e specialistë me njohuri të larta në këtë fushë.

Gjatë takimit iu kushtua një rëndësi e veçantë diskutimit mbi përpilimin e një dokumenti propozimesh e rekomandimesh për ndryshime në fushën e rentës minerare ku SHAV u ndal në: Thjeshtëzimin e procedurës së marrjes së rentës nga Ministria e Financave, Rritjen e rentës minerare nga 5% në 25-50% si dhe Shqyrtimin e Hec-eve në rentë.

SHAV do të jetë një aktor kyç në këtë proces për propozimin e një drafti konkret i cili është një mundësi shumë e mirë për bashkitë dhe komunitetet e vendit.



RRITJA E KAPACITETEVE

Zhvillimi i kapaciteteve në qeverisjen vendore dhe fuqizimi i administratës lokale është një prej përpjekjeve kryesore në ecurinë e reformës së administratës publike në nivel vendor. Prioriteti i SHAV është mbështetja e administratës lokale, për t'iu përgjigjur pritshmërive dhe nevojave të komunitetit për shërbime publike të specializuara.



EDUKIMI DHE SPORTI

Edukimi dhe sporti janë dy komponent tejet të rëndësishëm për zhvillimin e një ekosistemi social-kulturor të qëndrueshëm për çdo komunitet në vend. SHAV ka si mision që përmes nxitjes së bashkëpunimit shkollë-komunitet-familje në proceset promovuese dhe zhvilluese të formimit personal të të rinjve në njësinë vendore të përfshijë ata vetë në vendimmarrjet që kanë të bëjnë me të ardhmen e tyre personale.



MJEDISI

Bashkëpunim mes të gjithë aktorëve të njësive vendore për mbrojtjen dhe pasurimin e mjedisit të lokalitetit është një domosdoshmëri për ruajtjen dhe zhvillimin e ambientit ku këto komunitete punojnë dhe jetojnë.



FORUMI LOKAL

1 INTERVISTË NË EMISIONIN “WAKE UP” NË TOP CHANNEL ME DREJTORESHËN EKZEKUTIVE TË SHOQATËS PËR AUTONOMI VENDORE, ADELINA FARRICI, MBI BUXHETIN 2020



ÇFARË PO KËRKOJNË BASHKITË? BORXHET E AKUMULUARA, KORRIGJIMI I HARTËS TERRITORIALE, POLITIKAT FISKALE, E TË TJERË.

Wake Up: E nisim me takim tuaj të fundit ku në krah të kryebashkiakut ju kërkuat gjithashtu që të kishte një rregullim të hartës territoriale. A mendoni se do të mbetet kjo një kërkesë teknike apo do të kthehet si gjithmonë në një debat politik?

Adelina Farrici: Në fakt ne në datën 20 ishim tek komisioni i ligjeve pikerisht për të përfaqësuar pushtetin vendor për projektet-ligjin për buxhetin e vitit 2020 dhe garancia që ka kjo edhe ekipi i përfaqësimit ishte i një niveli të lartë si politik ashtu edhe ekzekutiv. Problemet që u trajtuan aty ishin shumë po unë po e nis tek pyetja juaj pjesa e korrigjimit të kufijëve. Realisht ajo ishte një kërkesë e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, i cili diskutimin e tij e ndau në dy pjesë, një pjesë si

Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore ku si kryetar kërkoi fuqizim, kryesisht për bashkitë e vogla të cilat nuk kanë shumë mundësi për grumbullim të ardhurash dhe kanë nevojë shumë për mbështetje nga pushteti qëndror.

Si Kryetari i Bashkisë së Tiranës ai foli duke u mbështetur në disa aspekte strategjike për Shqipërinë ku Tirana si kryeqytet dhe 1/3 ekonomisë dhe popullsisë së vendit kërkon një atashim të një pjese të territorit strategjik për investime pranë saj për fatin e mundësive që kjo bashki ka. Shembull është aeroporti “Nënë Tereza” që sot është pjesë administrative e bashkisë Krujë. Bashkia e Krujës ka qat shumë probleme sa aeroportin mund ta shikojë si dicka periferike për të investuar në aeroport. Bashkia e Tiranës duke patur pak me shumë mundësi financiare mund të bëjë investime më të mëdha për këtë pjesë. Ndërkohë, ne bëjmë takime të vazhdueshme me kryetarët e bashkive të cilët janë anëtarë të Shoqatës tonë dhe është ngritur shqetësimi i saktësimin të vijës ndarëse midis bashkive dhe nuk është ngritur shqetësimi i një ribërje ose rishikimit të hartave.

Wake Up: Ndërkohë që përvec Veliajt që kërkoj të marrë në administrim edhe Aeroportin e Rinasit, a keni ju kërkesa nga bashki të tjera për korigjimin e territorit dhe cilat janë disa nga këto bashki?

Adelina Farrici: Ka kërkesa për kufizimin p.sh. çështja e Librazhdit, ka edhe bashki të tjera, te cilat duan që të përfshihet një territor pak më i gjerë se një fshat por edhe një fshat në kufij i cili lidhet nga tradita, historia me këtë pjesën tjetër ku investohet.

Wake Up: Keni patur kërkesa në të gjitha propozimet që keni bërë lidhur me fondet që qeveria i kalon bashkive që thonë që është transferta e pakushtëzuar? Ne fakt si fond është gjithçka për një bashki pjesa që ju vjen gjithë investimi dhe gjithë të ardhurat financiare.

Adelina Farrici: Financat Vendore janë burime të ardhurash nga qeveria nga të ardhura që mbledhim vet dhe burimet të ardhura nga qeveria janë në formën e një transfertë të pakushtëzuar dhe jo specifike e të kushtëzuar. Transferat e pakushtëzuara, ku fal edhe lobimit të SHAV, u materializuan në ligjin për Vetqeverisjen Vendore të 2017 ku vendos një kufi dysheme. Pra n.q.s. nga ministria u kërkua 0.9% nga ne u kërkua që të jetë jo më pak se 1% dhe kemi futur tog-fjalëshin në ligj “jo me pak” se 1% te GDP-së pra të mos jetë një përqindje 5% mbi atë që ke marrë një vit më parë por të matet me GDP-në e atij viti. Ky ishte një sukses dhe ne tek Komisioni i Ligjeve kemi kërkuar pikërisht zbatimin e ligjit. Nga përlllogaritjet tona na dilte që jo 1% e GDP-së ishte grand i pakushtëzuar për bashkitë por ishte 0.965%. Madje na u tha nga përfaqëuesi i ministrisë që është një shumë e pakonsiderueshme por brenda kësaj shume ishte futur edhe buxheti për qarqet dhe ne kërkua që ky buxhet të zhvishet nga buxheti për qarqet dhe 1% të kaloj vetëm për qeverisjen vendore që janë bashkitë dhe morëm premtimin nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave që kjo do të realizohet. Gjithashtu kërkua edhe zbatimin e ligjit për taksën e ndarë që u realizua fal këmbënguljes së SHAV që taksë mbi tatimin e të ardhurave personale mund të jetë një taksë e ndarë për pushtetin vendor dhe qëndror dhe me ligj është që 2% e kësaj takse, ligj që ka hyrë në fuqi në Janar të 2018. 2% e kësaj takse të kaloj për pushtetin vendor dhe aktualisht kjo taksë duhet të kishte kaluar për 2018 dhe 2019 dhe nuk kanë kaluar akoma këto të ardhura tek pushteti vendor dhe ky ishte një nga problemet që ngritëm dhe nga Ministria e Financave morëm garancinë për zgjidhje. Këto të ardhura do të jenë

një burim i mirë për bashkitë madje kjo taksë mund të jetë edhe një incentivë që t'i nxisë kryetarët e bashkive për të ndërtuar politika punësimi pasi sa më shumë të punësuar të kenë në territorin e tyre aq më shumë do të marrim të ardhura nga taksë për të ardhurat.

Wake Up: Një ndër çështjet që në fakt është diskutuar nga ju por diskutuar gjatë e gjerë sidomos pas vendimit të Ministrisë së Financave për të patur një administrator apo menaxher le të themi të bashkive që vinte pikërisht nga qeveria, është pikërisht trajtimi i borxheve të akumuluar që ishte diku tek 6.2 miliard në total për të gjitha bashkitë. Cfarë kërkuat ju në këtë drejtim?

Adelina Farrici: Faleminderit për pyetjen e sillni këtë çështje në vemendje, tek një problem që është shumë i mprehtë dhe që nëse në këto momente kam kryebashkiak që po me dëgjojnë, sepse është një problem që është ngritur në vazhdimësi nga pushteti vendor. Reforma territoriale krahas gjërave të mira solli dhe problematika dhe një prej tyre ishte që kryetarët e rinj u ballafaquan jo vetëm me menaxhimin e një territori më të madh, por edhe me borxhe të krijuara nga ish-njësitë e mëparshme të cilat do të mbëtreshin tek pushteti vendor.

Ne në vazhdimësi kemi kërkuar që keto borxhe, dhe do ishte gjë shumë e mirë që në momentin e reformës territoriale të ishte filluar me një start pa borxhe dhe në vazhdimësi kërkesa jonë që këto borxhe të lehtësohen dhe pse jo të shlyhen nga pushteti qëndror. Gjithsesi ne e mirëkuptojmë që borxhet e akumuluar nga pushteti vendor patjetër që duhet të shlyhen nga bashkitë dhe këtu kemi një menaxhim të mirë se nga 30 miliard që ishte në 2015, sot jemi në shifrat 6.2 miliard, çka do të thotë që pushteti vendor e ka menaxhuar mirë vit pas viti borxhin duke e shlyer atë ndonëse ky nuk është i vetmi borxh që ka pushteti vendor. Pjesë e këtij borxhi është krijuar si rezultat i granteve kompetitive të pushtetit qëndror që do të thotë pushteti vendor aplikon me projekte dhe fondi është i pushtetit qëndror. Ky fond, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve dikur, sot i quajtur Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të gjitha detyrimet e pashlyera të ardhura prej tij për investime nuk mund të quhen borxh që i përket pushtetit vendor. Ai duhet të kaloj nga pushteti qëndror. Për këtë na u dha premtimi nga Ministria e Financës që të gjithë këto borxhe të krijuara si rezultat i investimeve të kryera nga pushteti qëndror do ti kalojnë atij. Kjo do të jetë një barrë e lehtësuar për pushtetin vendor dhe një frymëmarrje për të.

AKTIVITETE TË TJERA TË SHAV

SHAV merr pjesë në lançimin e “Vjetarit Statistikor Rajonal 2019”

Më 22 Nëntor 2019, SHAV mori pjesë në lançimin e publikimit të “Vjetarit Statistikor Rajonal 2019”. Ky Vjetar paraqet për herë të parë publikime të dhënash në nivel bashkie dhe qarku. Disa nga temat kryesore të trajtuara ishin: Forca e punës, Edukimi, Shëndetësia, Agrikultura, Turizmi dhe Transporti e shumë tema të tjera.



Pjesë e panelit në këtë aktivitet ishin zyrtar të pushtetit lokal dhe të qeverisjes qendrore si Drejtori Ekzekutiv i SHAV, Drejtoresha e Përgjithshme i INSAT dhe përfaqësues të tjerë të trupit diplomatik dhe organizatat e përfshira në këtë studim. Risi e kësaj veprimtarie ishte edhe krijimi i një sistemi online me anë të të cilit mund të merret informacion mbi të dhënat që kanë vet Bashkitë.



MARMARA URBAN FORUM 2019 MBI SHKËMBIMI I IDEVE DHE QASJEVE TË NDRYSHME NË FUNKSION TË SHËRBIMEVE DHE MENAXHIMIT SA MË TË MIRË URBAN



Marmara Urban Forum 2019 i cili zhvillohet në datat 1-3 tetor në Stamboll është një forum mbarëkombëtar i cili mbledh më shumë 3000 pjesëmarrës dhe 200 folës nga 25 vende të ndryshme të botës, mes tyre dhe Shoqata për Autonominë Vendore si përfaqësuese e pushtetit vendor të Shqipërisë. Qëllimi i këtij eventi është shkëmbimi i ideve dhe qasjeve të ndryshme në funksion të shërbimeve dhe menaxhimit sa më të mirë urban. E pranishme në këtë aktivitet, SHAV bashkë me homologët e saj u angazhuan për më shumë bashkëpunim dhe nxitje në kuadër të përfshirjes së

qytetarëve në bashkëqeverisje. Kjo duke patur parasysh peshën dhe rolin e tyre në funksion të zhvillimit të qyteteve dhe hapësirave tona urbane.

Gjatë tremujorit të kaluar SHAV ka zhvilluar një takim me përfaqësues të Komisionit të Venecias lidhur me projektligjin për përmbylljen e procesit të pronësisë në Shqipëri. Gjatë takimit u bisedua mbi projektligjin, ku SHAV ndau opinionet e saj në lidhje me këtë dokument të rëndësishëm që ka një rëndësi të veçantë për vetë demokracinë dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

HISTORI SUKSESI PROJEKTI SUMP



SHQIPËRIA BËHET PJESË E 3136 QËNDRAVE ADMINISTRATIVE EVROPIANE QË SYNOJNË NDËRGJEGJËSIMIN E QYTETARËVE PËR PËRDORIMIN E TRANSPORTIT EKOLOGJIK

Gjatë muajit tetor Shqipëria u bë pjesë e 3136 qyteteve dhe njësive vendore të regjistruara dhe angazhuara në projektin e Bashkimit Evropian të "Javës së Mobilitetit Evropian" zhvilluar rreth kontinentit evropian. Projekti SUMP që zbatohet në Shqipëri nga Shoqata për Autonomi Vendore me mbështetjen GIZ Albania u bë pjesë e kësaj iniciative mbarë evropiane duke organizuar aktivitete në disa bashki të vendit. E tërë java u shndërrua në një

fushatë sensibilizimi e cila ka si qëllim ndërgjegjësimin e institucioneve dhe qytetarëve për përdorim si transport alternativ atë ekologjik. Përmes projektit SUMP, Shoqata për Autonomi Vendore po punon për promovimin dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve dhe institucioneve mbi format e reja të lëvizshmërisë së pastër, për të shfrytëzuar sfidat aktuale të transportit dhe përparimin drejt një lëvizshmërie më të qëndrueshme për bashkitë e vendit si pjesë e bashkësive evropiane.

TRAJNIMI PËR MENXHIMIN E CIKLIT TË PROJEKTIT NGA BASHKITË E VENDIT SIGURON MË TEPËR PROJEKTE ZHVILLIMI PËR KOMUNITETET LOKALE

Në kuadër të rritjes së kapaciteve njerëzore të bashkive të vendit, Shoqata për Autonomi Vendore ka zhvilluar gjatë muajit dhjetor një cikël seminaresh trajnues disa ditore me tematikë Menaxhimin e Ciklit të Projektit (MCP) e cila është një metodë e menaxhimit të projekteve që bazohet në përcaktimin e saktë të fazave të ciklit të jetës së një projekti me aktivitete menaxhuese të përcaktuara mirë dhe me procedura vendimmarrëse të lidhura me çdo fazë.

Përcaktimi i qartë dhe realist i objektivave të projekteve dhe programeve, sigurimin e një

cilësie të lartë përgjatë gjithë ciklit të projektit, si për shembull përzgjedhja e një teknologjie të përshtatshme, respektimi i vlerave social-kulturore, kapacitetet institucionale, qëndrueshmëria, etj.) si dhe tema mbi sigurimin e konsistencës dhe kontributit drejt “objektivave afatgjata të politikave” të cilat janë pika të rëndësishme dhe mundësojnë vazhdimësinë e suksesshme të projektit.

Në këtë cikël seminaresh trajnimi, kontributor ishin dhe kolegët e #ANTTARC, të cilët ofruan ekspertizën e tyre në ciklin e MCP si një prej metodave më avangarde të përdorura nga organizatat ndërkombëtare.



ANËTARËT



Bashkia Belsh



Bashkia Brat



Bashkia Bulqizë



Bashkia Cërrik



Bashkia Delvinë



Bashkia Devoll



Bashkia Dibër



Bashkia Divjakë



Bashkia Dropull



Bashkia Durrës




Bashkia Elbasan



Bashkia Fier



Bashkia Finiq



Bashkia Fushë-Arrëz



Bashkia Gjirokastër



Bashkia Gramsh



Bashkia Has



Bashkia Himarë



Bashkia Kamëz



Bashkia Kavajë



Bashkia Këlcyrë



Bashkia Klos



Bashkia Kolonjë



Bashkia Konispol



Bashkia Korçë



Bashkia Krujë




Bashkia Kuçovë



Bashkia Kukës



Bashkia Kurbin



Bashkia Lezhë



Bashkia Libohovë



Bashkia Librazhd



Bashkia Lushnjë



Bashkia Malësi e Madhe



Bashkia Maliq



Bashkia Mallakastër



Bashkia Mat



Bashkia Memaliaj



Bashkia Mirditë



Bashkia Patos



Bashkia Peqin



Bashkia Përmet



Bashkia Pogradec



Bashkia Poliçan



Bashkia Prrerjas



Bashkia Pukë



Bashkia Pustec



Bashkia Roskovec



Bashkia Rrogozhinë



Bashkia Selenicë



Bashkia Shijak



Bashkia Skrapar



Bashkia Tepelenë



Bashkia Tiranë



Bashkia Tropojë



Bashkia Ura Vajgurore



Bashkia Vau i Dejës



Bashkia Vlorë



Bashkia Vorë

PARTNERËT

Shoqata për Autonomi Vendore, ka për qëllim të llojë e të jetë një zë i fuqishëm në bazë të politikave e të vizionit të cilat janë paraqitur në statutë, për të mbrojtur e monitoruar interesat e anëtarësisë. Ndaj për ne partneriteti dhe bashkëpunimi me shoqatat homologe ndërkombëtare në përfitim të eksperiencave më të mira europiane dhe rajonale është një domosdoshmëri. Sot Shoqata operon në partneritet të ngushtë me rrjetet më të rëndësishme të shoqatave lokale Europiane dhe JugLindore dhe është një anëtare me të drejta të plota në European Association for Local Democracy.



UNITED NATIONS



UNDP



EU COMMISSION



EU DELEGATION



USAID



US EMBASSY IN TIRANA



SWISS COOPERATION



GIZ



HANS SEIDEL FOUNDATION



FRIEDRICH EBERT STIFTUNG FOUNDATION



OPEN SOCIETY FOUNDATION



OSCE



GOVERNMENT OF ALBANIA



PARLIAMENT OF ALBANIA



NALAS



CCER



EUROPEAN ASSOCIATION OF LOCAL DEMOCRACY



EMILIA ROMAGNA



CNVP



AUSTRIAN DEVELOPMENT COOPERATION



FOUNDATION FOR LOCAL AUTONOMY AND GOVERNANCE



KDZ



WORLD VISION



FEDERATA KOMBËTARE E PYJEVE DHE KULLOTAVE KOMUNALE



VNG INTERNATIONAL



DECENTRALIZATION AND LOCAL DEVELOPMENT PROGRAMME



THE WORLD BANK

SË BASHKU NDËRTOJMË TË ARDHMEN E KOMUNITETIT TONË!



**SHOQATA
PËR AUTONOMINË
VENDORE**

Na vizitoni në www.shav.al